FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 3

Tiranë – E premte, 5 janar 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 99/2023, datë 14.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995, "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", të ndryshuar.....	135
Dekret i Presidentit nr. 394, datë 27.12.2023	Për shpallje ligji.....	140
Dekret i Presidentit nr. 400, datë 29.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	140
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 28.12.2023	Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse.....	140
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 788, datë 28.12.2023	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara.....	146
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 28.12.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare", të ndryshuar.....	177
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 28.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 699, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor '*By-pass*' Vlorë (shtesa)", të ndryshuar.....	181
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 800, datë 28.12.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Institutit të Policisë Shkencore", Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.....	183

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 28.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 501, datë 25.8.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve afganë dhe personave pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit, dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare", të ndryshuar.....	184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 28.12.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 173, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve ukrainas, personave pa shtetësi dhe personave që kanë fituar mbrojtje ndërkombëtare në Ukrainë, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Ukrainë, si dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare", të ndryshuar.....	185
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 28.12.2023	Për hapjen e misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në Bosnjë dhe Hercegovinë.....	185
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 613, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020, 'Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare'".....	185
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 820, datë 28.12.2023	Për autorizimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për dhënien e bursave nxënësve të institucionit arsimor të mesëm të orientuar *"Peter Mahringer"*, Shkodër.....	188
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 28.12.2023	Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.....	189
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 825, datë 28.12.2023	Për miratimin e tarifave të shërbimeve dhe të analizave, që kryhen nga laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar.....	190
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 28.12.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", të ndryshuar.....	193
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 829, datë 28.12.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 500, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përjashtimin nga ndalimi i gjuetisë, për qëllime shkencore pasvaksinale, të kafshëve të vaksinuara, në kuadër të projektit IPA 2020, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së tërbimit – faza IV".....	195
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 1, datë 3.1.2024	Për delegim kompetence	195
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 747, datë 29.12.2023	Për delegim kompetence	196

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 214, datë 27.12.2023	Për një shtesë në urdhrin nr. 446, datë 18.12.2019, "Për miratimin e rregullores së brendshme, për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare".....	196
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 756, datë 22.12.2023	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut.....	197

LIGJ
Nr. 99/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7975, DATË 26.7.1995, "PËR BARNAT NARKOTIKE DHE LËNDËT PSIKOTROPE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995, "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Kudo në tekstin e ligjit emërtimet "ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit" dhe "ministri i Shëndetësisë" zëvendësohen me fjalët "ministri përgjegjës për shëndetësinë", emërtimi "ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit" zëvendësohet me fjalët "ministri përgjegjës për bujqësinë" dhe emërtimi "ministri i Rendit Publik" zëvendësohet me fjalët "ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike".

Neni 2

Në nenin 4 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Tabela II ndahet në dy grupe, A dhe B, sipas masave të kontrollit që zbatohen për to. Tabela III ndahet në tri grupe: A, B dhe C, sipas masave të kontrollit që zbatohen për to.".

2. Në fund të nenit 4 shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje:

"Përjashtim nga rregulli për "Tabela I" bëhet për bimën e *cannabis*-it dhe nënproduktet e saj për të cilat zbatohen dispozitat ligjore në fuqi, sipas legjislacionit përkatës për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës, si dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale.".

Neni 3

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9

Në Republikën e Shqipërisë ndalohen kultivimi i hashashit (*Papaver somniferum*) për prodhimin e opiumit dhe të kashtës, kultivimi i bimës së kokës (*Erythroxylon coca*) për prodhimin e alkaloideve e të lëndëve aromatike, si dhe kultivimi i të gjitha llojeve dhe varieteteve të bimëve të gjinisë *cannabis* për prodhimin e kanabisit, të rrëshirës dhe vajit.

Lejohet përjashtimisht përpunimi i bimës së *cannabis*-it dhe prodhimi i nënprodukteve të saj vetëm për qëllime mjekësore dhe industriale, sipas legjislacionit të posaçëm të miratuar për këtë qëllim.".

Neni 4

Pas paragrafit të parë, të nenit 11, shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

"Përjashtim nga parashikimet e paragrafit të parë të këtij neni bëhet për bimën e *cannabis*-it dhe nënproduktet e saj për të cilat zbatohen dispozitat ligjore në fuqi, sipas legjislacionit përkatës për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it, dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale.".

Neni 5

Në fjalinë e dytë të nenit 17 termi "ndihmësfarmacist" zëvendësohet me termin "farmacist".

Neni 6

Neni 103 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 103

Skema e klasifikimit dhe tabelat e barnave narkotike, lëndëve psikotrope dhe përgatesave të tyre janë sipas skemës dhe tabelave I, II dhe III, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse të tij.".

Neni 7

Skema e klasifikimit dhe tabelat I, II dhe III, që i bashkëlidhen ligjit nr. 7975, datë 26.7.1995, të ndryshuar, zëvendësohen me skemën e klasifikimit dhe tabelat I, II dhe III, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 8

Në fund të tabelave të ligjit paragrafët *) dhe **) zëvendësohen me paragrafin *) me këtë përmbajtje:

"*) Renditja e barnave narkotikë, lëndëve psikotrope dhe lëndëve të tjera në tri tabela dhe nëntë lista është bërë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe Konventës për Barnat Narkotike të vitit 1961 dhe Konventës për Lëndët Psikotrope të vitit 1971, të rishikuara, dhe që janë në fuqi që prej 1 korrikut 1993.".

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.12.2023.

Shpallur me dekretin nr. 394, datë 27.12.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Tabela I - Lista IV (Konventa e 1961)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
ACETORPHINE	3-O-acetyltetrahydro-7α-(1 -hydroxy-1 -methylbutyl)-6,14-endo-ethenooripavine (derivative of thebaine)
ACETYL-ALPHA-METHYLFENTANYL	N-[1-(α-methylphenethyl)-4-piperidyl]acetanilide
ACETYLFENTANYL	N-Phenyl-N-[1-(2-phenylethyl)-4-piperidinyl]acetamide
ALPHA-METHYLFENTANYL	N-[1-(α-methylphenethyl)-4-piperidyl]propionanilide
ALPHA-METHYLTHIOFENTANYL	N-[1-[1-methyl-2-(2-thienyl)ethyl]-4-piperidyl]propionanilide
BETA-HYDROXYFENTANYL	N-[1-(β-hydroxyphenethyl)-4-piperidyl]propionanilide
BETA-HYDROXY-3-METHYLFENTANYL	N-[1-(β-hydroxyphenethyl)-3-methyl-4-piperidyl]propionanilide
CANNABIS	the flowering or fruiting tops of the cannabis plant (resin not extracted)
CANNABIS RESIN, EXTRACTS and TINCTURES	the separated resin, crude or purified, obtained from the cannabis plant
CARFENTANIL	Methyl 1-(2-phenylethyl)-4-[phenyl(propanoyl)amino]piperidine-4-carboxylate
DESOMORPHINE	Dihydrodesoxymorphine (derivative of morphine)
ETORPHINE	tetrahydro-7α-(1 -hydroxy-1 -methylbutyl)-6,14-endo-ethenooripavine (derivative of thebaine)
HEROIN	diacetylmorphine (derivative of morphine)
KETOBEMIDONE	4-m-hydroxyphenyl-1-methyl-4-propionylpiperidine
3-METHYLFENTANYL	N-(3-methyl-1-phenethyl-4-piperidyl)propionanilide
3-METHYLTHIOFENTANYL	N-[3-methyl-1-[2-(2-thienyl)ethyl]-4-piperidyl]propionanilide
MPPP	1-methyl-4-phenyl-4-piperidinol propionate (ester)
para-FLUOROFENTANYL	4'-fluoro-N-(1-phenethyl-4-piperidyl)propionanilide
PEPAP	1-phenethyl-4-phenyl-4-piperidinol acetate (ester)
THIOFENTANYL	N-[1-[2-(2-thienyl)ethyl]-4-piperidyl]propionanilide

Tabela I - Lista I (Konventa e 1971)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
CATHINONE	(-)-(S)-2-aminopropiophenone
DET	3-[2-(diethylamino)ethyl]indole
DMHP	3-(1,2-dimethylheptyl)-7,8,9,10-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-6*H*- dibenzo[*b,d*]pyran-1-ol
DMT	3-[2-(dimethylamino)ethyl]indole
DMA	(±)-2,5-dimethoxy- α-methylphenethylamine
DOET	(±)-4-ethyl-2,5-dimethoxy-α-methylphenethylamine
BROLAMFETAMINE, DOB	(±)-4-bromo-2,5-dimethoxy-α-methylphenethylamine
DOC	4-Chloro-2,5-dimethoxyamfetamine
ETRYPTAMINE	3-(2-aminobutyl)indole
(+)-LYSERGIDE, LSD, LSD-25	9,10-didehydro-*N,N*-diethyl-6-methylergoline-8*β*-carboxamide
mescaline	3,4,5-trimethoxyphenethylamine
MDMA	(±)-N,α-dimethyl-3,4-(methylenedioxy)phenethylamine
MMDA	5-methoxy-α-methyl-3,4-(methylenedioxy)phenethylamine
TENAMFETAMINE, MDA	α-methyl-3,4-(methylenedioxy)phenethylamine
4-methylaminorex	(±)-*cis*-2-amino-4-methyl-5-phenyl-2-oxazoline
methcathinone	2-(methylamino)-1 -phenylpropan-1 -one
4-MTA	α-methyl-4-methylthiophenethylamine
N-ethyl MDA, MDEA	(±)-*N*-ethyl-α-methyl-3,4-(methylenedioxy)phenethylamine
N-hydroxy MDA	(±)-*N*[α-methyl-3,4-(methylenedioxy)phenethyl]hydroxylamine
25B-NBOMe	2-(4-bromo-2,5-dimethoxyphenyl)-*N*-(2-methoxybenzyl)ethanamine

25C-NBOMe	2-(4-chloro-2,5-dimethoxyphenyl)-*N*-(2-methoxybenzyl)ethanamine
25I-NBOMe	2-(4-iodo-2,5-dimethoxyphenyl)-*N*-(2-methoxybenzyl)ethanamine
parahexyl	3-hexyl-7,8,9,10-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-6*H*-dibenzo*[b,d]*pyran-1-ol
ETICYCLIDINE, PCE	*N*-ethyl-1 -phenylcyclohexylamine
ROLICYCLIDINE, PHP, PCPY	1-(1 -phenylcyclohexyl)pyrrolidine
psilocine, psilotsin	3-[2-(dimethylamino)ethyl]indol-4-ol
PSILOCYBINE	3-[2-(dimethylamino)ethyl]indol-4-yl dihydrogen phosphate
PMA	1 -(4-methoxyphenyl)propan-2-amine
PMMA	1-(4-methoxyphenyl)-2-methylaminopropane
STP, DOM	2,5-dimethoxy-α,4-dimethylphenethylamine
TENOCYCLIDINE, TCP	1-[1 -(2-thienyl)cyclohexyl]piperidine
TETRAHYDRO- CANNABINOL, THC	tetrahydrocannabinol, the following isomers and their stereochemical variants:
delta-6a(10a)-THC	7,8,9,10-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6*H*-dibenzo[*b,d*]pyran-1-ol
delta-6a(7)-THC	(9R,10aR)-8,9,10,10a-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6*H*- dibenzo[*b,d*]pyran-1-ol
delta-7-THC	(6aR,9R,10aR)-6a,9,10,10a-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6*H*- dibenzo[*b,d*]pyran-1-ol
delta-8-THC	(6aR,10aR)-6a,7,10,10a-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6*H*- dibenzo[*b,d*]pyran-1-ol
delta-10-THC	6a,7,8,9-tetrahydro-6,6,9-trimethyl-3-pentyl-6*H*-dibenzo[*b,d*]pyran-1-ol
delta-9(11)-THC	(6aR,10aR)-6a,7,8,9,10,10a-hexahydro-6,6-dimethyl-9-methylene3-pentyl-6*H*-dibenzo [*b,d*]pyran-1 -ol
TMA	(±)-3,4,5-trimethoxy-α-methylphenethylamine

Tabela II - Lista II (Konventa e 1961)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
ACETYLDIHYDROCODEINE	(derivative of codeine)
CODEINE	3-methylmorphine (derivate of morphine, alkaloid contained in opium and poppy straw)
DEXTROPROPOXYPHENE	α-(+)-4-dimethylamino-1,2-diphenyl-3-methyl-2-butanol propionate (Dextro-rotary isomer of propoxyphene)
DIHYDROCODEINE	(derivative of morphine)
ETHYLMORPHINE	3-ethylmorphine (derivative of morphine)
NICOCODINE	6-nicotinylcodeine (derivative of morphine)
NICODICODINE	6-nicotinyldihydrocodeine (derivative of morphine)
NORCODEINE	N-demethylcodeine (derivative of morphine)
PHOLCODINE	morpholinylethylmorphine (derivative of morphine)
PROPIRAM	N-(1-methyl-2-piperidinoethyl)-N-2-pyridylpropionamide

Tabela II - Lista II (Konventa e 1971)

LËNDA	EMËRTIMI KIMIK
AMFETAMINE, amphetamine	(±)-α-methylphenethylamine
AMINEPTINE	7-[(10,11 -dihydro-5H-dibenzo [*a,d*]cyclohepten-5-yl)amino]heptanoic acid
AM-2201, JWH-2201	[1 -(5-Fluoropentyl)- 1H-indol-3-yl](naphthalen-1-yl)methanone
5F-APINACA, 5F-AKB-48	N-(adamantan-1-yl)-1-(5-fluoropentyl)-1H-indazole-3- carboxamide
5F-AMB, 5F-AMB-PINACA	Methyl 2-({[1 -(5-fluoropentyl)-1H-indazol- 3yl]carbonyl}amino)-3-methylbutanoate
2C-B	4-bromo-2,5-dimethoxyphenethylamine
AB-CHMINACA	N-[(2S)-1 -amino-3-methyl-oxobutan-2-yl] -1-(cyclohexylmethyl)- 1H-indazole-3-carboxamide
CUMYL-4CN- BINACA	1 -(4-cyanobutyl)-N-(2-phenylpropan-2-yl)- 1H-indazole-3-carboxamide
ADB- CHMINACA, MAB-CHMINACA	N- [(2S)-1 -amino-3,3-dimethyl-1 -oxobutan-2-yl]-1 -(cyclohexylmethyl)-1H-indazole-3-carboxamide
4-CMC (4- chloromethcathinone), clephedrone	1 -(4-chlorophenyl)-2-(methylamino)-1-propanone
CUMYL- PEGACLONE	5-Pentyl-2-(2-phenylpropan-2-yl)-2,5-dihydro-1H-pyrido [4,3-b]indol-1 -one
DEXAMFETAMINE, dexamphetamine	(+)-α-methylphenethylamine
DRONABINOL, *delta-9*-tetrahydrocannabinol and its stereochemical variants	(6aR,10aR)-6a,7,8,10a-tetrahydro-6,6,9- trimethyl-3-pentyl-6H-dibenzo[*b,d*]pyran- 1-ol
diphenidine	1-(1,2-Diphenylethyl)piperidine
ethylone	(RS)-1 -(1,3-Benzodioxol-5-yl)-2-(ethylamino)propan-1-one
ethylphenidate	ethyl 2-phenyl-2-piperidin-2-ylacetate [1]
Eutylone	
FENETYLLINE	7-[2-[(a-methylphenethyl)amino]ethyl]theophylline
4- fluoroamphetamine, 4-FA	1 -(4-Fluorophenyl)propan-2-amine
FUB-AMB, MMB- FUBINACA, AMB- FUBINACA	Methyl(2S)-2-({1-[4-fluorophenyl]methyl-1H-indazole-3-carbonyl }amino)-3-methylbutanoate
ADB-FUBINACA	N- [(2S)-1 -amino-3,3-dimethyl-1 -oxobutan-2-yl]-1-[(4-fluorophenyl)methyl]-1H-indazole-3-carboxamide
AB-FUBINACA	N-[(2S)-1 -amino-3-methyl-1-oxobutan-2-yl]-1 -[(4-fluorophenyl)methyl]indazole-3-carboxamide
gamma- HYDROXYBUTIRIC ACID, GHB	y-hydroxybutyric acid
JWH-018, AM-678	Naphthalene- 1-yl(1 -pentyl- 1H-indol-3-yl)methanone
LEVAMFETAMINE , levamphetamine	(-)-(R)-α-methylphenethylamine
LEVMETAMFETAMINE, levomethamphetamine	(-)-N,α-dimethylphenethylamine

MECLOQUALONE	3-(o-chlorophenyl)-2-methyl-4(3*H*)- quinazolinone
METAMFETAMINE, methamphetamine	(+)-(S)-N,α-dimethylphenethylamine
METHAQUALONE	2-methyl-3-o-tolyl-4(3*H*)-quinazolinone
METHYLPHENIDATE	methyl α-phenyl-2-piperidine acetate
METAMFETAMINE RACEMATE, methamphetamine racemate	(±)-N,α-dimethylphenethylamine
MDPV, 3,4-methylenedioxypyrovalerone	(RS)-1 -(Benzo[*d*][1,3]dioxol-5-yl)-2-(pyrrolidin-1 -yl)pentan-1 -one
mephedrone, 4-methylmethcathinone	(RS)-2-methylamino-1-(4-methylphenyl)propan- 1-one
methylone, *beta*-keto-MDMA	(RS)-2-methylamino-1-(3,4- methylenedioxyphenyl)propan-1 -one
methoxetamine, MXE	(RS)-2-(3-methoxyphenyl)-2-(ethylamino)- cyclohexanone
MDMB-CHMICA	methyl 2-[[1-(cyclohexylmethyl)indole-3- carbonyl]amino]-3,3dimethylbutanoate
methiopropamine, MPA	1-(thiophen-2-yl)-2-methylaminopropane
4-methylethcathinone, 4-MEC	2-(Ethylamino)-1 -(4-methylphenyl)propan-1 -one
5F-MDMB-PICA	Methyl(S)-2-(1-(5-fluoropentyl)-1H-indole-3- carboxamido)-3,3-dimethylbutanoate
4F-MDMB- BINACA	Methyl(S)-2-(1-(4-fluorobutyl)-1H-indazole-3- carboxamido)-3,3-dimethylbutanoate
MDMB-4en- PINACA	Methyl 3,3-dimethyl-2-(1- (pent-4-en-1-yl)-1H-indazole-3- carboxamido)butanoate
3-Methoxyphencyclidine	1-(1-(3-Methoxyphenyl)cyclohexyl)piperidine
N-benzylpiperazine, benzylpiperazine, BZP	1 -benzylpiperazine
N-ethylnorpentylone	1 -(2H- 1,3-benzodioxol-5-yl)-2-(ethylamino)pentan-1 -one
N-ethylhexedrone	2-(Ethylamino)-1 -phenyl-1 -hexanone
PHENCYCLIDINE, PCP	1-(1 -phenylcyclohexyl)piperidine
PHENMETRAZINE	3-methyl-2-phenylmorpholine
5F-ADB, 5F-MDMB-PINACA	Methyl(2S)-2- {[1 -(fluoropentyl)-1H-indazole-3-carbonyl]amino}-3,3-dimethylbutanoate
AB-PINACA	N-[(2S)-1 -Amino-3-methyl-1 -oxobutan-2-yl] -1- pentyl-1H-indazole-3-carboxamide
alpha-PVP	α-pyrrolidinovalerophenone
para-Methyl-4- methylaminorex, 4,4'-DMAR	4-Methyl-5-(4-methylphenyl)-4,5-dihydro-1,3-oxazol-2- amine
pentedrone	(±)-2-(methylamino)-1 -phenylpentan-1 -one
5F-PB-22	Quinolin-8-yl 1-(5-fluoropentyl)-1H-indole-3-carboxylate
alpha-PHP	(RS)-1 -Phenyl-2-(pyrrolidine-1 -yl)hexan-1 -one
SECOBARBITAL	5-allyl-5-(1 -methylbutyl)barbituric acid
UR-144	(1-Pentyl-1H-indol-3-yl)(2,2,3,3- tetramethylcyclopropoyl)methanone
XLR-11	[1 -(5-Fluoropentyl)- 1H-indol-3- yl](2,2,3,3tetramethylcyclopropyl)methanone
ZIPEPROL	α-(α-methoxybenzyl)-4-(β-methoxyphenethyl)-1-piperazineethanol
ADB-BUTINACA	N-[1-(Aminocarbonyl)-2,2-dimethylpropyl]-1-butyl-1H-indazole-3-carboxamide
alpha-PiHP	4-methyl-1-phenyl-2-(pyrrolidin-1-yl)pentan-1-one
3-Methylmethcathinone	2-(Methylamino)-1-(3-methylphenyl)propan-1-one
GBL	Gamma-butyrolactone; γ-butyrolactone
Ketamine	Ketamine

TABELA III - LISTA III (KONVENTA E 1961)

1. Përgatesat e acetildihidrokodeinës, dihidrokodeinës, etilmorfinës, folkodinës, kodeinës, nikodikodinës, nikokodinës dhe norkodeinës kur kombinohen me një ose më shumë ingredient të tjerë dhe që përmbajnë jo më shumë se 100 mg të barit narkotik për dozë, si dhe përgatesat e padozuara me një përqendrim jo më shumë se 2.5 për qind.

2. Përgatesat e propiramit që përmbajnë jo më shumë se 100 mg propiram për dozë dhe të kombinuara të paktën me të njëjtën sasi metilceluloze.

3. Përgatesat e dekstropropoksifenit për përdorim nga goja që përmbajnë jo më shumë se 135mg dekstropropoksifën bazë për dozë ose përgatesat e padozuara me një përqendrim jo më shumë se 2.5 për qind, me kusht që këto përgatesa të mos përmbajnë ndonjë lëndë që janë në kontroll sipas Konventës për lëndët psikotrope të vitit 1971.

4. Përgatesat e kokainës që përmbajnë jo më shumë se 0,1 për qind kokainë e llogaritur si kokainë bazë dhe përgatesat e opiumit ose të morfinës që përmbajnë jo më shumë se 0,2 për qind morfinë e llogaritur si morfinë bazë pa ujë, si dhe të kombinuara me një ose më shumë ingredientë të tjerë në një mënyrë të tillë që bari narkotik nuk mund të rimerret lehtësisht dhe në sasi që të rrezikojë shëndetin e popullatës.

5. Përgatesat e difenoksinës që përmbajnë jo më shumë se 0,5 mg difenoksinë për dozë dhe një sasi sulfat atropine të paktën 5 për qind të dozës së difenoksinës.

6. Përgatesat e difenoksilatit që përmbajnë jo më shumë se 2.5 mg difenoksilat për dozë, llogaritur si bazë dhe një sasi sulfat atropine ekuivalente me të paktën 1 për qind të dozës së difenoksilatit.

7. Pulvis ipecacuanhae et opii compositus:
Pluhur opiumi 10 për qind;
Pluhur i rrënjës së ipekes 10 për qind i përzierë me 80 për qind pluhur plotësues që nuk përmban ndonjë bar narkotik.

8. Përgatesat e lartpërmendura dhe të kombinuara me përgatesa të tjera që nuk përmbajnë barna narkotike.

Tabela III - Lista III (Konventa e 1971)

LËNDA	**EMËRTIMI KIMIK**
AMOBARBITAL	5-ethyl-5-isopentylbarbituric acid
BUTALBITAL	5-allyl-5-isobutylbarbituric acid
BUPRENORPHINE	2l-cyclopropyl-7-α-[(S)-1-hydroxy-1,2,2- trimethylpropyl] -6,14-endo-ethano-6,7,8,14-tetrahydrooripavine
CYCLOBARBITAL	5-(1-cyclohexen-1-yl)-5-ethylbarbituric acid

CATHINE, (+)- norpseudoephedrine	(+)-(S)-α-[(S)-1-aminoethyl]benzyl alcohol
FLUNITRAZEPAM	5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-1-methyl-7-nitro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
GLUTETHIMIDE	2-ethyl-2-phenylglutarimide
PENTOBARBITAL	5-ethyl-5-(1-methylbutyl)barbituric acid
PENTAZOCINE	(2R*,6R*,11R*)-1,2,3,4,5,6-hexahydro-6,11-dimethyl-3-(3-methyl-2-butenyl)-2,6-methano-3-benzazocin-8-ol

Tabela III - Lista IV (Konventa e 1971)

LËNDA	**EMËRTIMI KIMIK**
AMFEPRAMONE, diethylpropion	2-(diethylamino)propiophenone
ALPRAZOLAM	8-chloro-1-methyl-6-phenyl-4H-s-triazolo[4,3-a][1,4]benzodiazepine
ALLOBARBITAL	5,5-diallylbarbituric acid
AMINOREX	2-amino-5-phenyl-2-oxazoline
BARBITAL	5,5-diethylbarbituric acid
BENZFETAMINE,benzphetamine	N-benzyl-N,α-dimethylphenethylamine
BROMAZEPAM	7-bromo-1,3-dihydro-5-(2-pyridyl)-2H-1,4- benzodiazepin-2-one
BUTOBARBITAL	5-butyl-5-ethylbarbituricacid
BROTIZOLAM	2-bromo-4-(o-chlorophenyl)-9-methyl-6H-thieno[3,2- *f*]-s-triazolo[4,3-*a*][1,4]diazepine
CAMAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-5-phenyl-*2H*-1,4-benzodiazepin-2-one dimethylcarbamate (ester)
CHLORDIAZEPOXIDE	7-chloro-2-(methylamino)-5-phenyl-3H-1,4- benzodiazepine-4-oxide
CLOBAZAM	7-chloro-1-methyl-5-phenyl-1H-1,5-benzodiazepine- 2,4(3H,5H)-dione
CLONAZEPAM	5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-7-nitro-2H-1,4- benzodiazepin-2-one
CLORAZEPATE	7-chloro-2,3-dihydro-2-oxo-5-phenyl-1H-1,4-benzodiazepine-3-carboxylic acid
CLOTIAZEPAM	5-(o-chlorophenyl)-7-ethyl-1,3-dihydro-1-methyl-2H-thieno[2,3-e]-1,4-diazepin-2-one
CLOXAZOLAM	10-chloro-11b-(o-chlorophenyl)-2,3,7,11b-tetrahydro-oxazolo- [3,2-*d*][1,4]benzodiazepin-6(5H)-one
CLONAZOLAM	6-(2-Chlorophenyl)-1 -methyl-8-nitro-4H- benzo [*f*][1,2,4]triazolo [4,3-*d*][1,4]diazepine
DELORAZEPAM	7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-2H-1,4- benzodiazepin-2-one
DIAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-1 -methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
DICLAZEPAM	7-Chloro-5-(2-chlorophenyl)-1-methyl-1,3-dihydro-2H-benzo [*e*][1,4]diazepin2-one
ETHCHLORVYNOL	1 -chloro-3-ethyl-1-penten-4-yn-3-ol
ETHINAMATE	1 -ethynylcyclohexanolcarbamate
ESTAZOLAM	8-chloro-6-phenyl-4*H-s*-triazolo[4,3- *a*/[1,4]benzodiazepine
ETHYL LOFLAZEPATE	ethyl 7-chloro-5-(o-fluorophenyl)-2,3-dihydro-2-oxo-1H-1,4-benzodiazepine-3-carboxylate
ETILAMFETAMINE, N-ethylamphetamine	N-ethyl-α-methylphenethylamine
ETIZOLAM	4-(2-Chlorophenyl)-2-ethyl-9-methyl-6H-thieno [3,2-f][1,2,4]triazolo[4,3a][1,4]diazepine
FLUDIAZEPAM	7-chloro-5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-1-methyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
FLURAZEPAM	7-chloro-1-[2-(diethylamino)ethyl]-5-(o-fluorophenyl)-1,3-dihydro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
FENCAMFAMIN	N-ethyl-3-phenyl-2-norbornanamine
FENPROPOREX	(±)-3-[(α-methylphenylethyl)amino]propionitrile
FLUALPRAZOLAM	8-Chloro-6-(2-fluoro-phenyl)-1 -methyl-4h- benzo [f][1,2,4]triazolo [4,3-a][1,4]diazepime
FLUBROMAZOLAM	8-Bromo-6-(2-fluorophenyl)-1 -methyl-4H-benzo[*f*] [1,2,4]triazolo [4,3-*d*][1,4]diazepine
HALAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-1-(2,2,2-trifluoroethyl)-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
HALOXAZOLAM	10-bromo-11b-(o-fuorophenyl)-2,3,7,11b- tetrahydrooxazolo[3,2-*d*] [1,4]benzodiazepin-6(5H)-one
KETAZOLAM	11 -chloro-8,12b-dihydro-2,8-dimethyl-12b-phenyl-4H-[1,3]oxazino[3,2-d][1,4]benzodiazepin-4,7(6H)-dione
LEFETAMINE, SPA	(-)-N,N-dimethyl-1,2-diphenylethylamine
LOPRAZOLAM	6-(*o*-chlorophenyl)-2,4-dihydro-2-[(4-methyl-1-piperazinyl)methylene]-8-nitro-1H-imidazo[1,2-a][1,4]benzodiazepin-1-one
LORAZEPAM	7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-3-hydroxy-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
LORMETAZEPAM	7-chloro-5-(o-chlorophenyl)-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
MAZINDOL	5-(p-chlorophenyl)-2,5-dihydro-3H-imidazo[2,1-a]isoindol-5-ol
MEPROBAMATE	2-methyl-2-propyl-1,3-propanedioldicarbamate
METHYLPHENOBARBITAL	5-ethyl-1-methyl-5-phenylbarbituric acid
METHYPRYLON	3,3 -diethyl-5-methyl-2,4-piperidine-dione
MEDAZEPAM	7-chloro-2,3-dihydro-1-methyl-5-phenyl-1H-1,4-benzodiazepine
MEFENOREX	N-(3-chloropropyl)-α-methylphenethylamine
MIDAZOLAM	8-chloro-6-(o-fluorophenyl)-1 -methyl-4H-imidazo[1,5-a][1,4]benzodiazepine
MESOCARB	3-(α-methylphenethyl)-N-(phenylcarbamoyl)sydnone imine
NIMETAZEPAM	1,3-dihydro-1-methyl-7-nitro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
NITRAZEPAM	1,3-dihydro-7-nitro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
NORDAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
OXAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
OXAZOLAM	10-chloro-2,3,7,11b-tetrahydro-2-methyl-11b-phenyloxazolo[3,2-d][1,4]benzodiazepin-6(5H)-one
PHENDIMETRAZINE	(+)-(2S,3S)-3,4-dimethyl-2-phenylmorpholine
PHENOBARBITAL	5-ethyl-5-phenylbarbituric acid
PHENTERMINE	α,α-dimethylphenethylamine
PIPRADROL	1,1 -diphenyl-1 -(2-piperidyl)methanol
PINAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-5-phenyl-1-(2-propynyl)-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
PRAZEPAM	7-chloro-1-(cyclopropylmethyl)-1,3-dihydro-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
PYROVALERONE	4' -methyl-2-(1 -pyrrolidinyl)valerophenone

PEMOLINE	2-amino-5-phenyl-2-oxazolin-4-one
PHENAZEPAM, FENAZEPAM	7-bromo-5-(2-chlorophenyl)-1,3-dihydro-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
SECBUTABARBITAL	5-sec-butyl-5-ethylbarbituric acid
TEMAZEPAM	7-chloro-1,3-dihydro-3-hydroxy-1-methyl-5-phenyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
TETRAZEPAM	7-chloro-5-(1 -cyclohexen-1-yl)-1,3-dihydro-1-methyl-2H-1,4-benzodiazepin-2-one
TRIAZOLAM	8-chloro-6-(o-chlorophenyl)-1 -methyl-4H-s-triazolo[4,3- a][1,4] benzodiazepine
VINYLBITAL	5-(1-methylbutyl)-5-vinylbarbituric acid
ZOLPIDEM	N,N,6-trimethyl-2-p-tolylimidazo[1,2-a]pyridine-3-acetamide

Tabela III (lista V)	
LËNDA	**EMËRTIMI KIMIK**
Nitrous oxide; N2O	Oxodiazen-2-ium-1-ide

DEKRET
Nr. 394, datë 27.12.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 99/2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995, 'Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 400, datë 29.12.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

- Eno Fatmir Peçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

AKT NORMATIV
Nr. 8, datë 28.12.2023

PËR MARRJEN E MASAVE URGJENTE, PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS, PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA QË SHKARKOHEN PRANË OSE NË UJËRA LARËSE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky akt normativ ka si qëllim trajtimin e ujërave të ndotura nëpërmjet vendosjes së impiantit apo sistemit të grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura nga ana e subjekteve, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat nuk i trajtojnë ujërat e ndotura, të krijuara nga veprimtaria e tyre ekonomike, dhe i shkarkojnë ato pranë ose në ujëra larëse.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij akti normativ, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Agroturizëm", veprimtaria pritëse që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrokulturore, me qëllimin për të tërhequr vizitorë, shpeshherë duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtaritë bujqësore ose veprimtaritë e tjera

ndihmëse që zhvillohen në atë mjedis bujqësor. Agroturizmi mbështet zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm të zonave rurale nëpërmjet mbrojtjes së ambientit, ruajtjes së traditave dhe promovimit të produkteve tipike të zonës.

2. "Bujtinë" (shtëpi pritëse), një ndërtesë, një pjesë e së cilës përdoret si rezidencë e pronarit dhe ku ofrohet akomodim dhe ushqim për turistët, përkundrejt pagesës.

3. "Fjetinë" (hostel), një ndërtesë që ofron akomodim dhe ushqim me çmime ekonomike, zakonisht për udhëtarë, studentë dhe punëtorë, ku dhoma ndahet mes disa klientëve të ndryshëm.

4. "Fshat turistik tradicional", një zonë në të cilën është dhënë leja e ndërtimit për të ndërtuar disa struktura akomoduese rezidenciale, për t'u shitur ose vënë në dispozicion të turistëve vendas, të huaj, individë ose grupe të organizuara dhe ka një përqendrim të lartë të burimeve dhe sipërmarrjeve turistike, i cili ka kapacitet për të tërhequr vizitorë vendas e të huaj, me një infrastrukturë të harmonizuar dhe mjedise që plotësojnë kërkesat e tyre.

5. "Fjetje dhe mëngjes (B&B)", strukturë akomoduese që ofron shërbimin e fjetjes dhe mëngjesit brenda çmimit të dhomës. Kjo strukturë akomoduese nuk ofron shërbim restoranti dhe ambiente të përbashkëta.

6. "Hotel", një ndërtesë me jo më pak se 6 (gjashtë) dhoma, ku akomodimi dhe shërbime si ushqim, pije etj. ofrohen nga një staf i kualifikuar, kundrejt një çmimi të afishuar.

7. "Kamping", një zonë publike ose private, e rrethuar, e pajisur me infrastrukturë të domosdoshme (ujë, tualete, energji elektrike etj.), ku udhëtarët mund të akomodohen në tendat e kampingut apo të ngrenë tendat e tyre ose të parkojnë mjetin motorik akomodues (*kamper*).

8. "Kompleks turistik", një zonë në të cilën është dhënë leja e ndërtimit për të ndërtuar disa struktura akomoduese rezidenciale, për t'u shitur ose vënë në dispozicion të turistëve vendas, të huaj, individë ose grupe të organizuara.

9. "Motel", ndërtesë që ofron shërbim akomodimi dhe parkimi, zakonisht me synimin për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve, me vendndodhje në periferi të qendrave të banuara, pranë kryqëzimeve dhe rrugëve automobilistike.

10. "Njësi shërbimi", të gjitha subjektet, të cilat ofrojnë shërbimin për bar, restorant ose mensë në zonat bregdetare, liqenore ose lumore, fshatra turistike apo komplekse turistike.

11. "Resort", një kompleks ndërtesash për pushim dhe argëtim, të grupuara e të administruara së bashku, si hotele, apartamente, vila, studio, që u ofron klientëve akomodim, ushqim, pije, veprimtari sportive e argëtuese dhe shërbime ndihmëse, nëpërmjet një stafi të kualifikuar.

12. "Strukturë akomoduese", struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 (një) vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera), në përputhje me standardet e përcaktuara, sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj.

13. "Subjektet e kategorisë I", subjektet që shkaktojnë ngarkesën e ndotjes deri në 50 PE.

14. "Subjektet e kategorisë II", subjektet që shkaktojnë ngarkesën e ndotjes deri në 180 PE.

15. "Subjektet e kategorisë III", subjektet që shkaktojnë ngarkesën e ndotjes më shumë se 180 PE.

16. "Ujëra larëse", çdo element uji sipërfaqësor, ku autoriteti kompetent parashikon të ketë një numër të madh njerëzish për t'u larë dhe ku nuk ka vendosur ndalim të përhershëm për t'u larë apo rekomandim për të mos u larë.

17. "Trajtim i ujërave të ndotura", në kuptim të këtij akti normativ, nënkupton trajtimin e ujërave të ndotura, nëpërmjet vendosjes së impiantit të trajtimit dhe ndërtimit të sistemit të grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura (në vijim sisteme individuale) nga subjektet që kryejnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, e cila përfshin:

a) ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të kanalizimeve të brendshme;

b) ndërtimin dhe funksionimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane;

c) ndërtimin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimeve për largimin e ujërave të ndotura urbane deri në kolektor;

ç) trajtimin dhe evadimin e llumrave dhe lëndëve të ngurta që dalin nga impiantet e trajtimit.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij akti zbatohen për subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike, sipas pikave 1 deri

12, të nenit 2, të këtij akti normativ, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuara, sipas standardeve të parashikuara pranë ose në ujërat larëse.

Neni 4
Detyrat e subjekteve

1. Subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas pikave 1 deri 12, të nenit 2, të këtij akti normativ, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve (në vijim subjektet) kanë detyrimin që, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, vendosin impiantin ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas rregullores teknike, të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

2. Detyrimin për të vendosur impiantin ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura sipas rregullave teknike të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin, e kanë edhe zhvilluesit e fshatrave turistike, sipas lejes së ndërtimit.

3. Subjektet që kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat shkarkojnë ujërat e ndotura në gropat septike, marrin masat për zëvendësimin e tyre me impiant ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas detyrimeve të përcaktuara në këtë akt normativ dhe në rregulloren teknike.

4. Të gjitha objektet që janë duke u zhvilluar ose ndërtuar në zonat bregdetare, ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, me qëllim zhvillimin e veprimtarisë ekonomike, sipas pikave 1 deri 12, të nenit 2, të këtij akti normativ, kanë detyrimin të bëjnë vendosjen e impiantit ose sistemeve individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas detyrimeve të përcaktuara në këtë akt normativ dhe në rregulloren teknike, përpara marrjes së certifikatës së përdorimit.

Neni 5
Standardet për trajtimin e ujërave të ndotura

1. Në kuptim të këtij akti normativ, standardet për trajtimin e ujërave të ndotura, që duhet të zbatohen nga subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, janë rregullat e përcaktuara në rregulloren teknike për standardet për trajtimin e ujërave të ndotura.

2. Ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe ministri përgjegjës për mjedisin, me udhëzim të përbashkët, miratojnë rregulloren teknike për standardet për trajtimin e ujërave të ndotura, sipas këtij akti normativ, në përputhje me parashikimet e shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", të ndryshuar.

Neni 6
Task-Forca

1. Për monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave, në zbatim të këtij akti normativ, me qëllim rregullimin e pasojave që vijnë nga mostrajtimi i ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse në zonat bregdetare, ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, ngrihet një Task-Forcë, në varësi të titullarit të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (në vijim AKUK).

2 Task-Forca e ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë 1-vjeçare, e cila mund të zgjatet me urdhër të Kryeministrit.

3. Marrëdhëniet e punës së titullarit dhe punonjësve të Task-Forcës rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

4. Struktura organizative dhe rregullorja e funksionimit të Task-Forcës miratohen me urdhër të Kryeministrit.

5. Fondet e nevojshme për funksionimin, shpenzimet, si dhe për bazën e nevojshme materiale dhe teknike të Task-Forcës përballohen nga buxheti i shtetit.

Neni 7
Detyrat e Task-Forcës

1. Task-Forca, në ushtrimin e funksioneve të veta, ka këto detyra:

a) Kontrollin në terren për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 4, të këtij akti normativ, nga subjektet përkatëse, veprimtaritë e të cilave prodhojnë ujëra të ndotura pranë ose në ujëra larëse, duke përfshirë kontrollin për:

i. vendosjen e impiantit apo sistemit individual të trajtimit të ujërave të ndotura, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë akt normativ dhe me rregulloren teknike, të miratuara me udhëzim të përbashkët;

ii. zëvendësimin e gropave septike me impiante apo sisteme individuale për trajtimin e ujërave të ndotura;

b) Mbledhjen e informacionit dhe krijimin e një databaze për të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse;

c) Evidentimin, në rastet kur ka, të sistemeve të brendshme të kanalizimeve dhe teknologjisë së përdorur për trajtimin dhe largimin e ujërave të ndotura të patrajtuara për të gjitha subjektet që i shkarkojnë pranë ose në ujërat larëse;

ç) Marrjen e masave administrative në rastet kur konstatohen shkeljet, sipas këtij akti normativ;

d) Ushtrimin e kontrolleve për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta, pranë ose në ujëra larëse. Për kryerjen e kësaj detyre Task-Forca bashkëpunon me inspektoratet apo strukturat përkatëse që mbulojnë fushën e mbrojtjes së mjedisit, organin që ka licencuar veprimtarinë, inspektoratin sanitar ose inspektoratin bashkiak;

dh) Pas kryerjes së inspektimit apo monitorimit të subjekteve që kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare, liqenore, lumore ose fshatrat turistikë, vendosjen e një tabele për trajtimin ose jo të ujërave të zeza në një vend të dukshëm nga publiku, sipas formatit në aneksin I, bashkëlidhur këtij akti normativ;

e) Përgatitjen, në fund të muajit tetor të një raporti për subjektet, për të cilat është marrë masa administrative, sipas këtij akti normativ, dhe propozimin organeve përgjegjëse për heqjen e licencës, të lejes ose të autorizimit për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ndaj subjekteve që nuk kanë plotësuar standardet edhe pas vendosjes së masave administrative.

2. Task-Forca në kryerjen e funksioneve të veta mbështetet, rast pas rasti, edhe nga Policia e Shtetit.

Neni 8
Masat administrative

1. Task-Forca, pas kryerjes së monitorimit dhe inspektimit, kur konstaton mosvendosjen e impiantit apo sistemit individual në përputhje me rregullat teknike për trajtimin e ujërave të ndotura nga subjektet, merr masat administrative, si më poshtë vijon:

a) Subjektet e kategorisë I dënohen me gjobë, në masën nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë deri në 1 850 000 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

b) Subjektet e kategorisë II dënohen me gjobë, në masën nga 1 900 000 (1 milion e nëntëqind mijë) deri në 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) lekë;

c) Subjektet e kategorisë III dënohen me gjobë, në masën nga 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) deri në 2 650 000 (dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) Zhvilluesi/ndërtuesi, sipas lejes së ndërtimit të fshatrave turistikë, dënohet me gjobë, në masën nga 2 400 000 (dy milionë e katërqind mijë) deri në 2 650 000 (dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

2. Mosvendosja apo heqja e tabelës, sipas shkronjës "dh", të nenit 7, dënohet me gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, nga Task-Forca.

3. Të ardhurat nga vendosja e masave administrative derdhen në buxhetin e shtetit.

4. Masat administrative të vendosura sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, dhe të pikës 2, të nenit 9, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor.

5. Për moszbatimin e detyrimit sipas pikës 4, të nenit 4, të këtij akti normativ, subjektet nuk marrin certifikatën e përdorimit për objektin ose projektin e ndërtuar apo të zhvilluar.

Neni 9
Procedura pas vendosjes së masës administrative

1. Task-Forca, me vendosjen e masës administrative sipas nenit 8, të këtij akti normativ, u lë një afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh subjekteve përkatëse për plotësimin e standardeve për trajtimin e ujërave të ndotura, sipas këtij akti normativ.

2. Kur pas afatit 60 (gjashtëdhjetë)-ditor, Task-Forca konstaton mosplotësimin e standardeve nga

subjektet e dënuara, dënon me gjobë, me vlerë dyfishin e masës së vendosur ndaj subjektit përkatës herën e parë.

3. Task-Forca, me përfundimin e sezonit turistik, sipas njoftimit nga ministria përgjegjëse për turizmin, i propozon institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave për heqjen e licencë, lejes ose autorizimit, për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ndaj të gjitha subjekteve, të cilat nuk kanë plotësuar standardet për trajtimin e ujërave të ndotura edhe pas marrjes së masës administrative, sipas pikës 2, të këtij neni.

4. Task-Forca, pas vendosjes së masës administrative ndaj zhvilluesit, sipas shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 8, të këtij akti normativ, i propozon institucioneve përgjegjëse për ndjekjen e procedurës për përjashtimin e zhvilluesit nga e drejta për të marrë leje zhvillimi ose ndërtimi për 5 (pesë) vjet, sipas parashikimeve në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim", të ndryshuar.

5. Zhvilluesi, sipas lejes së ndërtimit të fshatrave turistikë apo kompleksеve turistike, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, përcjell pranë Task-Forcës planin e masave për plotësimin e standardeve për trajtimin e ujërave të ndotura. Plani i masave nuk duhet të kalojë afatin 90 (nëntëdhjetë)-ditor, të vendosur në këtë akt normativ, për plotësimin e standardeve për trajtimin e ujërave të ndotura.

Neni 10
Ankimi i masave administrative

Subjektet kanë të drejtë që të ankimojnë vendimin për marrjen e masave administrative pranë gjykatës kompetente për çështjet administrative.

Neni 11
Dispozita të fundit

1. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e aktit normativ, ministrat përgjegjës miratojnë rregullat teknike, sipas pikës 2, të nenit 5.

2. Subjektet që kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve e të lumenjve, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, duhet të plotësojnë standardet për trajtimin e ujërave të ndotura, sipas këtij akti normativ.

3. Subjektet që duhet të ndërtojnë impiantin e trajtimit, sipas këtij akti normativ, duhet të pajisen me deklaratë paraprake punimesh, sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, dhe vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për rregulloren e zhvillimit të territorit", të ndryshuar, dhe të kryejnë "njoftimin për fillimin e punimeve" pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK).

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS I

21 cm
21 cm
KY SUBJEKT
TRAJTON
UJËRAT
E NDOTURA
21 cm
KY SUBJEKT
NUK TRAJTON
UJËRAT
E NDOTURA

VENDIM
Nr. 788, datë 28.12.2023

PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMET E LEGALIZUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet e legalizuara në drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës: Tiranë Jug, Tiranë Veri, Tiranë Rurale 1, Tiranë Rurale 2, Kamzë–Vorë, Elbasan, Berat, Gjirokastër, Lezhë, Durrës, zonat e stimuluara, Kavajë dhe Vlorë.

2. Vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 266 494 525,23 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e pesë presje njëzet e tre) lekë, për sipërfaqen 39 279,54 (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë presje pesëdhjetë e katër) m^2, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë me numrat rendorë sipas kolonës 14, të shtojcës 1, përkatësisht: nr. 12, nr. 13, nr. 19, nr. 26, nr. 30, nr. 37, nr. 38, nr. 40, nr. 51, nr. 64, nr. 68, nr. 83, nr. 84, nr. 89, nr. 92, nr. 93, nr. 119, nr. 120, nr. 145, nr. 154, nr. 171, nr. 172, nr. 173 dhe nr. 175, sipas seksionit të veçantë (kolona 19) të shtojcës 1, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, sipas pikave 3 dhe 4, të nenit 24, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

4. Të ardhurat që arkëtohen nga drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen, përdoren për kompensimin e pronarëve.

31. Gjermania
32. Gjibraltari
33. Grenada
34. Grenlanda
35. Greqia
36. Holanda
37. Hong Kongu (Kinë)
38. Hungaria
39. India
40. Indonezia
41. Irlanda
42. Ishujt e Virgjër Britanikë
43. Ishujt Faroe
44. Ishujt Kajman
45. Ishujt Kuk
46. Ishujt Marshall
47. Ishujt Turks dhe Kaikos
48. Ishulli i Manit
49. Islanda
50. Italia
51. Izraeli
52. Japonia
53. Kaledonia e Re
54. Kanadaja
55. Katari
56. Kazakistani
57. Kenia
58. Kili
59. Kina (Republika Popullore)
60. Kolumbia
61. Korea
62. Kosta Rika
63. Kroacia
64. Kurasao
65. Kuvajti
66. Letonia
67. Libani
68. Liberia
69. Lihtenshtajni
70. Lituania
71. Luksemburgu
72. Makao (Kinë)

73. Malajzia
74. Maldivet
75. Mali i Zi
76. Malta
77. Maroku
78. Mauritius
79. Mbretëria e Bashkuar
80. Meksika
81. Moldavia
82. Monako
83. Montserrati
84. Nauru
85. Nigeria
86. Niue
87. Norvegjia
88. Omani
89. Pakistani
90. Panamaja
91. Peruja
92. Polonia
93. Portugalia
94. Qipro
95. Republika Çeke
96. Republika Sllovake
97. Ruanda
98. Rumania
99. Samoa
100. San Marino
101. Sejshells
102. Singapori
103. Sint Marten
104. Sllovenia
105. Spanja
106. Suedia
107. Shën Kits dhe Nevis
108. Shën Luçia
109. Shën Vinsenti dhe Grenadinet
110. Shqipëria
111. Tajlanda
112. Turqia
113. Uganda
114. Ukraina
115. Uruguaji
116. Vanuatu
117. Xhamajka
118. Xhersi
119. Zelanda e Re
120. Zvicra

SHTOJCA II
LISTA E JURIDIKSIONEVE TË RAPORTUESHME

1. Afrika e Jugut
2. Andorra
3. Anguila
4. Antigua dhe Barbuda
5. Arabia Saudite
6. Argjentina
7. Australia
8. Austria
9. Azerbaixhani
10. Barbadosi
11. Belgjika
12. Bermuda
13. Brazili
14. Brunei Darusalam
15. Bullgaria
16. Danimarka
17. Dominika
18. Ekuadori
19. Emiratet e Bashkuara Arabe
20. Estonia
21. Finlanda
22. Franca
23. Gana
24. Gërnzi
25. Grenada
26. Grenlanda
27. Greqia
28. Gjermania
29. Gjibraltari
30. Holanda
31. Hong Kongu (Kinë)
32. Hungaria
33. India
34. Indonezia
35. Irlanda
36. Ishujt e Virgjër Britanikë
37. Ishujt Faroe
38. Ishujt Kajman
39. Ishujt Kuk
40. Ishujt Turks dhe Kaikos
41. Ishulli i Manit
42. Islanda
43. Italia
44. Izraeli
45. Japonia
46. Kaledonia e Re

47. Kanadaja
48. Kazakistani
49. Kili
50. Kina
51. Kolumbia
52. Korea
53. Kosta Rika
54. Kroacia
55. Kurasao
56. Kuvajti
57. Letonia
58. Liberia
59. Lihtenshtajni
60. Lituania
61. Luksemburgu
62. Makao (Kinë)
63. Malajzia
64. Malta
65. Maroku
66. Mauritius
67. Mbretëria e Bashkuar
68. Meksika
69. Monako
70. Montserrati
71. Nauru
72. Nigeria
73. Norvegjia
74. Omani
75. Pakistani
76. Panamaja
77. Peruja
78. Polonia
79. Portugalia
80. Qipro
81. Republika Çeke
82. Republika Sllovake
83. Rumania
84. Rusia
85. San Marino
86. Sejshells
87. Singapori
88. Sint Marten
89. Sllovenia
90. Spanja
91. Suedia
92. Shën Kits dhe Nevis
93. Shën Luçia
94. Shën Vinsenti dhe Grenadinet
95. Turqia
96. Uruguaji
97. Vanuatu
98. Xhersi
99. Zelanda e Re
100. Zvicra

VENDIM
Nr. 820, datë 28.12.2023

PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT PËR DHËNIEN E BURSAVE NXËNËSVE TË INSTITUCIONIT ARSIMOR TË MESËM TË ORIENTUAR *"PETER MAHRINGER"*, SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 39, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës", dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Autorizimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për dhënien e bursave nxënësve të institucionit arsimor të mesëm të orientuar "*Peter Mahringer*", Shkodër, në zbatim të marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 9522, datë 25.4.2006, dhe protokollit përkatës.
2. Efektet financiare mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 821, datë 28.12.2023

PËR NGRITJEN DHE ORGANIZIMIN E NJËSIVE TË PËRHERSHME TË KËRKIM-STUDIMIT NË ALBANOLOGJI PRANË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 53/2019, "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë (në vijim, Akademia) të njësive të përhershme të kërkim-studimit, si njësi vijuese të veprimtarisë në fushën e albanologjisë të njësive kryesore të Akademisë së Studimeve Albanologjike, si më poshtë vijon:

a) Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë;

b) Instituti i Arkeologjisë;

c) Instituti i Historisë;

ç) Instituti i Antropologjisë;

d) Qendra e Studimit të Arteve;

dh) Qendra për Botimet Enciklopedike e Albanologjike (QBEA).

2. Qëllimi, fusha e kërkimit të njësive të përhershme të kërkim-studimit, mënyra e funksionimit dhe e organizimit të tyre, organet drejtuese dhe strukturat përbërëse përcaktohen në statutin e tyre përkatës, pjesë përbërëse e statutit të Akademisë.

3. Njësitë e përhershme të kërkim-studimit organizohen dhe funksionojnë sipas përcaktimeve në statutin e Akademisë, në rregulloret e brendshme të tyre dhe kuadrin ligjor në fuqi. Marrëdhëniet dhe raportet e njësive të përhershme të kërkim-studimit me strukturat ekzistuese të Akademisë dhe me organet e saj drejtuese rregullohen sipas përcaktimeve në ligjin nr. 53/2019, "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në statutin e Akademisë.

4. Njësitë e përhershme të kërkim-studimit të organizuara si institute drejtohen nga drejtori dhe kanë në përbërje departamentet, të cilat drejtohen nga përgjegjësit e tyre, ndërsa njësitë e përhershme të kërkim-studimit të organizuara si qendra drejtohen nga drejtori dhe kanë në përbërje sektorët, të cilët drejtohen nga përgjegjësit e tyre. Në mbështetje të këtyre njësive të përhershme, funksionon dhe administrata ndihmëse e këtyre njësive, në bashkëpunim me administratën e Akademisë, si pjesë e nën drejtimin e saj, në përputhje me rregulloret e brendshme të këtij institucioni.

5. Njësitë e kërkim-studimit të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, kanë buxhetin e tyre si zë më vete në buxhetin vjetor të Akademisë, i cili detajohet për shpenzimet e personelit dhe shpenzimet e tjera korrente me vendim të Kryesisë së Akademisë. Procedurat për çeljen e buxhetit të tyre përcaktohen në udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit.

6. Njësitë e kërkim-studimit në albanologji e ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe përdorin asetet, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, së bashku me tërësinë e aseteve dhe të fondeve të trashëgimisë të kaluara në administrim të Akademisë, nëpërmjet vendimit nr. 338, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj".

7. Marrëveshjet në fuqi, nënshkruar nga përfaqësues të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA) apo të njësive në përbërje të saj me institucione apo njësi të ngjashme, vendase apo të huaja, ruajnë vlefshmërinë juridike për sa kohë nuk ka kërkesë për revokim nga palët nënshkruese përgjegjëse. Marrëveshjet e lidhura në nivel institucional ndiqen nga Akademia, ndërsa marrëveshjet me palë nënshkruese njësitë e ASA-s ndiqen nga njësitë e përhershme përkatëse të kërkim-studimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

8. Kërkuesit shkencorë të njësive të përhershme gëzojnë të njëjtin status si të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Kategoria dhe struktura e pagave të tyre përcaktohen në përputhje me vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë", të ndryshuar. Për personelin akademik, nivelet e pagave sipas kufirit minimal të vendimit të sipërcituar garantohen nga buxheti i shtetit i miratuar për Akademinë.

9. Për personelin administrativ, kategoria dhe struktura e pagave të tyre përcaktohen në përputhje

me shkronjën "ç", të pikës 1, të vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike".

10. Për punonjësit mbështetës, kategoria dhe struktura e pagave të tyre përcaktohen në përputhje me vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës edhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike".

11. Organika e njësive të përhershme të kërkim-studimit për punonjësit kërkimorë, shkencorë, administrativë dhe mbështetës përbëhet nga 127 (njëqind e njëzet e shtatë) punonjës.

12. Të ardhurat e ASA-s për vitin 2023 trajtohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor për arsimin e lartë, duke u mbartur dhe në vitin 2024, dhe përdoren me vendim të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, për njësitë përgjegjëse të përcaktuara në këtë vendim.

13. Ngarkohet Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1.1.2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 825, datë 28.12.2023

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE DHE TË ANALIZAVE, QË KRYHEN NGA LABORATORI I REFERENCËS DHE LABORATORËT E MIRATUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 23, të ligjit nr. 17/2020, "Për produktet plehëruese", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të shërbimeve dhe të analizave të produkteve plehëruese, që kryhen nga laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TARIFAT E SHËRBIMEVE DHE TË ANALIZAVE TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE

Nr.	Klasifikimi në grupe	Lloji i analizës	Vlera në lekë
A.	**Produktet plehëruese inorganike**		
1	**URE**		**5 000**
1.1		Përmbajtja e azotit (N)	3 500
1.2		Përmbajtja e lagështisë	500
1.3		Përmbajtja e amoniakut të lirë (NH_3)	500
1.4		Përmbajtja e kokrrizave (granulometria)	500
2	**NITRAT AMONI**		**5 000**
2.1		Përmbajtja e azotit (N)	3 500
2.2		Përmbajtja e lagështisë	500
2.3		Përmbajtja e lëndëve të patretshme	500
2.4		Përmbajtja e kokrrizave (granulometria)	500
3	**SUPERFOSFAT**		**11 000**
3.1		Përmbajtja e penta oksidit të fosforit (P_2O_5)	5000

3.2		Përmbajtja e acidit fosforik të lirë (H_3PO_4)	5000
3.3		Përmbajtja e lagështisë	500
3.4		Përmbajtja e kokrrizave (granulometria)	500
4	**DAP**		**9 000**
4.1		Përmbajtja e azotit (N)	3 000
4.2		Përmbajtja e penta oksidit të fosforit (P_2O_5)	5 000
4.3		Përmbajtja e lagështisë	500
4.4		Përmbajtja e kokrrizave	500
5	**KALIUM**		**4 000**
5.1		Përmbajtja e oksidit të kaliumit (K_2O)	3 000
5.2		Përmbajtja e lagështisë	500
5.3		Përmbajtja e kokrrizave (granulometria)	500
6	**Produkt plehërues kompleks (N-P-K)**		**12 500**
6.1		Përmbajtja e azotit (N)	3 000
6.2		Përmbajtja e penta oksidit të fosforit (P_2O_5)	5 000
6.3		Përmbajtja e oksidit të kaliumit (K_2O)	3 000
6.4		Përmbajtja e lëndëve të patretshme	500
6.5		Përmbajtja e lagështisë	500
6.6		Përmbajtja e kokrrizave (granulometria)	500
B.	**Produktet plehëruese organike**		
1		Përmbajtja e pehashit (pH)	200
2		Përmbajtja e konduktivitetit elektrik (KE)	100
3		Përmbajtja e karbonit (C) organik	1 000
4		Përmbajtja e lagështisë	500
5		Përmbajtja azotit (N) total	1 500
6		Përmbajtja e penta oksidit të fosforit (P_2O_5) të tretshëm dhe në citrate amoni neutral	700
7		Përmbajtja e oksidit të kaliumit (K_2O)	700
8		**Mikroelementet**	
8.1		Përmbajtja e bakrit (Cu)	500
8.2		Përmbajtja e zinkut (Zn)	500
9		**Metalet e rënda**	
9.1		Përmbajtja e kadmiumit (Cd)	500
9.2		Përmbajtja e kromit hexavalent (Cr VI)	500
9.3		Përmbajtja e merkurit (Hg)	500
9.4		Përmbajtja e nikelit (Ni)	500
9.5		Përmbajtja e plumbit (Pb)	500
9.6		Përmbajtja e arsenikut inorganik (As)	500
C.	**Produktet plehëruese organo-minerare**		
1		Përmbajtja e pehashit (pH)	200
2		Përmbajtja e konduktivitetit elektrik (KE)	100
3		Përmbajtja e karbonit (C) organik	1 000
4		Përmbajtja e lagështisë	500
5		Përmbajtja azotit (N) total	1 500
6		Përmbajtja e penta oksidit të fosforit (P_2O_5) të tretshëm dhe në citrate amoni neutral	700
7		Përmbajtja e oksidit të kaliumit (K_2O)	700
8		**Mikroelementet**	
8.1		Përmbajtja e bakrit (Cu)	500
8.2		Përmbajtja e zinkut (Zn)	500

9		**Metalet e rënda**	
9.1		Përmbajtja e kadmiumit (Cd)	500
9.2		Përmbajtja e kromit hexavalent (Cr VI)	500
9.3		Përmbajtja e merkurit (Hg)	500
9.4		Përmbajtja e nikelit (Ni)	500
9.5		Përmbajtja e plumbit (Pb)	500
9.6		Përmbajtja e arsenikut inorganik (As)	500
Ç.	**Produktet plehëruese bazuar në elemente ushqyese dytësore**		
1.		Përmbajtja e trioksidit të squfurit (SO_3)	500
2		Përmbajtja e oksidit të kalciumit (CaO)	500
3		Përmbajtja e oksidit të magnezit (MgO)	500
4		Përmbajtja e natriumit total (Na)	500
D.	**Produktet plehëruese bazuar në mikroelemente**		
1.		Përmbajtja e borit (B) të tretshëm në ujë	500
2		Përmbajtja e kobaltit (Co)	500
3		Përmbajtja e bakrit (Cu)	500
4		Përmbajtja e hekurit (Fe)	500
5		Përmbajtja e manganit (Mn)	500
6		Përmbajtja e molibdenit (Mo)	500
7		Përmbajtja e zinkut (Zn)	500
DH.	**Produktet plehëruese me veprim specifik (frenuesit, biostimulantët e bimëve)**		
1		Përmbajtja e kadmiumit (Cd)	500
2		Përmbajtja e kromit hexavalent (Cr VI)	500
3		Përmbajtja e merkurit (Hg)	500
4		Përmbajtja e nikelit (Ni)	500
5		Përmbajtja e arsenikut (As)	500
6		Përmbajtja e bakrit (Cu)	500
E.	**Produktet plehëruese të veçanta**	Përmbajtja e silicit (Si)	500
Ë.	**Korrektuesit**		
1		Përmbajtja e kadmiumit (Cd)	500
2		Përmbajtja e kromit hexavalent (Cr VI)	500
3		Përmbajtja e merkurit (Hg)	500
4		Përmbajtja e nikelit (Ni)	500
5		Përmbajtja e plumbit (Pb)	500
6		Përmbajtja e arsenikut (As)	500
7		Përmbajtja e bakrit (Cu)	500
8		Përmbajtja e zinkut (Zn)	500
F.	**Substratet e kultivimit (rritjes)**		
1		Përmbajtja e kadmiumit (Cd)	500
2		Përmbajtja e kromit hexavalent (Cr VI)	500
3		Përmbajtja e merkurit (Hg)	500
4		Përmbajtja e nikelit (Ni)	500
5		Përmbajtja e plumbit (Pb)	500
6		Përmbajtja e arsenikut (As)	500
7		Përmbajtja e bakrit (Cu)	500
8		Përmbajtja e zinkut (Zn)	500
G.	**Përmirësuesit e tokës**		

1		Përmbajtja e magnezit (Mg)	500
2		Përmbajtja e kalciumit (CaO)	500
3		Përmbajtja e pehashit (Ph)	200
4		Përmbajtja e konduktivitetit elektrik (KE)	100
5		Përmbajtja e lëndës organike	1 000
6		Përmbajtja e hirit	500
7		Përmbajtja e karbonit (C) organik	1 000
8		Përmbajtja e lagështisë	500

VENDIM
Nr. 828, datë 28.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 686, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, fjala "... kalendarike ..." zëvendësohet me "... pune ...".

2. Në kreun I bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

i. Në shkronjën "i", të pikës 1.1, pas fjalës "... informacion ..." shtohet "... i detajuar ...";

ii. Shkronja "j" e pikës 1.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"j) Të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës ku do të zhvillohet projekti;";

iii. Paragrafi i fundit i pikës 1.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Raporti paraprak i VNM-së të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi fizik ose juridik, i certifikuar në përputhje me këtë ligj.";

iv. Pas pikës 1.4 shtohet pika 1.5, me këtë përmbajtje:

"1.5 Prokurë për autorizimin e aplikuesit kur nuk është i njëjtë me zhvilluesin".

b) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Ministria, me marrjen e aplikimit, verifikon paraprakisht nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi është në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij kreu dhe ia përcjell jo më vonë se 2 (dy) ditë pune Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), duke e shoqëruar me rekomandimin përkatës.

4. AKM-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit dhe dokumentacionit shoqërues, shqyrton kërkesën, bazuar edhe në rekomandimin e ministrisë, dhe në rast se konstaton se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit "*e-Albania*", duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga dita e njoftimit.".

c) Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2, me këtë përmbajtje:

"4/1. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit "*e-Albania*" për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera.

4/2. AKM-ja, kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditë pune, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre brenda 7 (shtatë) ditëve pune:

a) ministrive të linjës, në varësi të projektit;

b) drejtorive teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;

c) institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin / autorizimin /licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;

ç) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.".

ç) Pikat 5 e 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"5. ARM-ja, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, e dërgon për mendim nëpërmjet sistemit elektronik te njësia/të e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti, të cilat shprehen brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e aplikimit.".

"7. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 4/2, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën e shqyrtimit të kërkesës dhe brenda 22 (njëzet e dy) ditëve pune nga marrja e aplikimit, merr vendimin për VNM-në paraprake ose vendos që projekti t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, sipas formatit të shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi, ia përcjell vendimin zhvilluesit, duke informuar edhe ministrinë, si dhe e publikon në faqen e saj elektronike.".

d) Pika 11 shfuqizohet.

dh) Pika 12 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"12. Afati maksimal për dërgimin e vendimit te zhvilluesi është 24 (njëzet e katër) ditë pune nga aplikimi pranë ministrisë. Afati për plotësimin e dokumentacionit sipas pikave 4 dhe 9, të këtij kreu, nuk llogaritet në afatin maksimal. Në rast se zhvilluesi nuk plotëson dokumentacionin/ informacionin brenda afateve të përcaktuara në pikën 9, nënkupton që zhvilluesi ka hequr dorë nga aplikimi për VNM-në paraprake.".

3. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

i. Në shkronjën "j", të pikës 1.1, pas fjalës "... informacion ..." shtohet "... i detajuar ...";

ii. Shkronja "j" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"j) Të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës ku do të zhvillohet projekti";

iii. Fjalia hyrëse e pikës 1.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1.2 Informacioni për ndërveprimin me mjedisin të projektit të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi fizik ose juridik, i certifikuar në përputhje me këtë ligj, dhe përmban:";

iv. Pas pikës 1.2 shtohet pika 1.3, me këtë përmbajtje:

"1.3 Prokurë për autorizimin e aplikuesit kur nuk është i njëjtë me zhvilluesin.".

b) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Ministria, me marrjen e aplikimit, verifikon paraprakisht nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi është në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij kreu dhe ia përcjell jo më vonë se 2 (dy) ditë pune Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), duke e shoqëruar me rekomandimin përkatës.

4. AKM-ja, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit dhe dokumentacionit shoqërues, shqyrton kërkesën bazuar edhe në rekomandimin e ministrisë dhe, në rast se konstaton se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit "*e-Albania*", duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga dita e njoftimit.".

c) Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2, me këtë përmbajtje:

"4/1. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit "*e-Albania*" për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera.

4/2. AKM-ja, kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditëve pune, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre brenda 7 (shtatë) ditëve pune:

a) ministrive të linjës, në varësi të projektit;

b) drejtorive teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;

c) institucioneve të tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin / autorizimin / licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;

ç) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM), në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i

jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.".

ç) Pikat 5 dhe 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"5. ARM-ja, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, e dërgon për mendim nëpërmjet sistemit elektronik te njësia/të e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti, të cilat shprehen brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e aplikimit.".

"7. Afati maksimal nga marrja e njoftimit, sipas pikës 1, të këtij kreu, deri në njoftimin nëpërmjet sistemit elektronik të zhvilluesit, sipas pikës 6, të këtij kreu, është 25 ditë pune. Afati për plotësimin e dokumentacionit sipas pikës 4 të këtij kreu nuk llogaritet në afatin maksimal.".

d) Në pikën 10 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Shkronja "a" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Raportin e thelluar të VNM-së, të nënshkruar elektronikisht nga personi fizik ose juridik, i certifikuar në përputhje me këtë ligj.".

ii. Pas shkronjës "dh" shtohet shkronja "e", me këtë përmbajtje:

"e) Prokurë për autorizimin e aplikuesit kur nuk është i njëjtë me zhvilluesin";

dh) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"11. Ministria, me marrjen e aplikimit, verifikon paraprakisht nëse dokumentacioni i paraqitur nga zhvilluesi është në përputhje me kërkesat e pikës 10 të këtij kreu dhe ia përcjell brenda 3 (tri) ditëve pune Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), duke e shoqëruar me rekomandimin përkatës.".

4. Në kreun III bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikat 2 dhe 4, togfjalëshi "... brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve ..." zëvendësohet me "... brenda 10 (dhjetë) ditëve ...".

b) Në fund të shkronjës "c", të pikës 3, shtohen fjalët "... në rast se ka filluar zbatimi.".

II. Për të gjitha kërkesat e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi për t'u pajisur me VNM paraprake dhe deklaratë mjedisore zbatohen dispozitat ligjore në fuqi në kohën e aplikimit.

III. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 829, datë 28.12.2023

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 500, DATË 24.8.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI I GJUETISË, PËR QËLLIME SHKENCORE PASVAKSINALE, TË KAFSHËVE TË VAKSINUARA, NË KUADËR TË PROJEKTIT IPA 2020, KONTROLLIN DHE ÇRRËNJOSJEN E SËMUNDJES SË TËRBIMIT – FAZA IV"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja "b", e 2, të nenit 4, të ligjit nr. 60/2022, "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2, të vendimit nr. 500, datë 24.8.2023, të Këshillit të Ministrave, pas fjalëve "... dhjetor 2023 ..." shtohen "..., si dhe janar 2024 ...".

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, Drejtoria e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 1, datë 3.1.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave

Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga ora 12:00 e datës 3.1.2024 deri në datën 5.1.2024, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR
Nr. 747, datë 29.12.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga ora 10:00 e datës 29.12.2023 deri në përfundim të orarit zyrtar, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

URDHËR
Nr. 214, datë 27.12.2023

PËR NJË SHTESË NË URDHRIN NR. 446, DATË 18.12.2019, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME, PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME DETARE"

Në bazë të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 401, germa "b", të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe nenit 5, të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, "Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare, të miratuar me urdhrin nr. 446, datë 18.12.2019, bëhet shtesa si më poshtë:

a) Në nenin 38, pas shkronjës "n", shtohet shkronja "o", me përmbajtje si më poshtë:

"o) Normativat e personelit të Sektorit të Kontrollit Shtetëror të Flamurit dhe Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare, janë sipas lidhjes nr. 3, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.".

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Shtojca nr. 3

Normativat e uniformave të personelit të Sektorit të Kontrollit Shtetëror të Flamurit dhe Sektorit të Kontrollit Shtetëror Portual, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare

Nr.	Emërtimi i materialit	Njësia	Sasia	Afati në vite
1	Pantallona pune	palë	1	1
2	Xhaketë pune	copë	1	1
3	Kominoshe pune	copë	2	1
4	Këpucë pune 1/2 me qafë (*safety shoes*)	copë	1	1
5	Bluza dimërore	copë	2	1
6	Bluza verore	copë	2	1
7	Kokore plastike	copë	1	3
8	Doreza pune	copë	3	1
9	Kufje antizhurmë	copë	1	2
10	Jelek flourishent	copë	2	1
11	Çekiç metalik	copë	1	5
12	Mushama shiu	copë	1	1
13	Elektrik dore	copë	1	3
14	Çantë materiali lëkure	copë	1	3
15	Shenja dalluese	copë	1	1

URDHËR
Nr. 756, datë 22.12.2023

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E MAQEDONISË SË VERIUT

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-së, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Češinovo-Obleševo	Ularci*	
Delcevo*		
Karbinci	Karbinci*	
Kočani*		
Kratovo*		
Gostivar*		
Gradsko*		
Kriva Palanka*		
Kumanovo	Kumanovo*	
Kumanovo	Dolno Konjare*	
Kumanovo	Ljubodrag*	
Kumanovo	Tabanovce*	
Kumanovo	Recica*	
Makedonska Kamenica	Moshtica*	
Makedonska Kamenica	Preseka*	
Makedonska Kamenica	Glavovica*	
Novo Selo	Novo Selo	
Probištip	Drenok*	
Probištip	Shtalkovica*	
Probištip	Stalkovica*	
Rankovce*		
Staro Nagoričane	Staro Nagoričane*	
Staro Nagoričane	Arbanasko*	
Staro Nagoričane	Tromegja*	
Štip	Štip*	
Vinitsa	Vinitsa*	

Vinitsa	Vinicka Krshla*	
Vrapčište*		
Novatsi*		
Kavadartsi*		
Pehčevo*		
Zajas*		

Shënime. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Maqedonisë së veriut të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik, të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demostron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhër nr. 567, datë 29.9.2023, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut", shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2024 - Numri: 3
Datë: 2024/01/05 13:03:27
158aad6c-3f05-4b46-85a0-5ebdd3fb2f12

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë